

UNIVERSITETI I PRISHTINËS
" HASAN PRISHTINA "
FAKULTETI I EDUKIMIT FIZIK DHE I SPORTIT



LËNDA: BASKETBOLL

PUNIM DIPLOME
NIVELI MASTER

TEMA :

Vlerësimi i disa karakteristikave morfologjike dhe lëvizore bazike e situacionale tek basketbollistët e rinj (aktiv dhe jo-aktiv)

Mentori:
Prof.Dr. Hazir Salihu

Kandidati:
Valon Hoxha

PRISHTINË – 2017

PËRMBAJTJA

1. HYRJE

1.1. Vështrim i hulumtimeve të deritanishme.....10

2. QËLLIMI I PUNIMIT.....11

2.1 Hipotezat themelore12

3. METODOLOGJIA E PUNËS

3.1. MOSTRA E ENTITETEVE (TË TESTUARVE).....15

3.2. MOSTRA E NDRYSHOREVE..... 22

4 . MËNYRA E TESTIMIT– PËRSHKRIMI I TEKNIKËS SË MATJEVE

4.1. METODA E PËRPUNIMIT TË REZULTATEVE..... 33

5. ANALIZA DHE INTERPRETIMI I REZULTATEVE

5.1 Parametrat themelorë statistikorë të masave antropometrike..... 33

5.2 Parametrat themelorë statistikorë të testeve lëvizore.....35

5.3 Lidhmërit ndërmjet testeve lëvizore dhe atyre situacional 37

5.4 Ndryshimet ndërmjet grupeve në testet antropometrik 39

5.5 Ndryshimet ndërmjet grupeve në testet antropometrike dhe lëvizore 42

5.6 Ndryshimet ndërmjet grupeve në analiza t-testi.....42

6. VERTETIMI I HIPOTEZAVE

7. PERFUNDIME DHE REKOMANDIME..... 54

7 . CONCLUSION AND RECOMANDATION..... 56

8 . BIBLOGRAFIA..... 58

1. HYRJJE

Basketbolli si lojë karakterizohet me lëvizje polistrukturale dhe komplekse, ku hyjnë lëvizjet ciklike dhe aciklike të ndërlidhura në nivelin e lartë të përgaditjes fizike. Nëse e përqëndrojmë vëmendjen në zhvillimin e basketbollit bashkohorë do të shohim gjithnjë e më shumë dominim të aftësive lëvizore si aksioni dhe reaksioni. Lojën e basketbollit të cilën e karakterizon intensiteti i lartë i aktivitetit gjatë gjithë kohës për dyzetë minuta të kohëzgjatjes së saj, kërkohet nga lojtarët një përgatitje e gjerë e aftësive të veçanta funksionale dhe lëvizore si dhe karakteristika specifike. Duke shikuar gjenezën e basketbollit, vërehet se secili ekspert ka futur në praktikën e basketbollit elemente të cilat dallohen nga konceptet tradicionale stereotipe. Improvizimi i tyre është bazuar, jo vetëm në njohuri dhe përvojë por edhe në imagjinatë si pjesë e të menduaritë në krijimtari.

Loja e Basketbollit përbëhet nga karakteristika të shumta komplekse antropologjike ku agjiliteti, forca eksplozive dhe shpejtësia janë themelore në kryerjen e shumë strukturave lëvizore. Nga pikëpamja e analizës së strukturores dhe biomekanikës së lojës së basketbollit, është e rëndësishme që shumë lloje të strukturave lëvizore dominohen nga kërcimet e shumta (të cilat i ekzekutojnë kryesisht me qëllim që të vijnë te posedimi i topit, të hedhin topin në shportë si dhe parandalimin e hedhjeve të topit në shportë nga ana kundërshtare), shpejtësia (udhëheqja e topit, sulm tranzitor dhe kundërzbritjet) dhe agjiliteti (ndryshimi i drejtimit të lëvizjes).

Zhvillimi bashkohorë i basketbollit gjithnjë e më tepër bazohet në hulumtimet shkencore në modelimin e proceseve të trajningut. Qëndrimi i tillë kërkon zbulimin e ligjshmërive dhe lidhjeve ndërmjet fushave të ndryshme të statusit psikosomatik të cilat janë përgjegjëse ose veprojnë në ekzekutimin e detyrave të ndryshme lëvizore në lojën e basketbollit. Në kohën e sotme, niveli i

arritjes në sportin kulmor është aq i lartë sa që sportistët gjatë sistemeve të përgatitjes stërvitore mund të arrijnë ose ti tejkalojnë vetëm me anë të ngritjes më të madhe të efikasitetit stërvitor. Mirëpo rritja e efikasitetit supozohet, jo vetëm rritja e sasisë së punës por në rend të parë organizim më të mirë të procesit stërvitor, zgjedhja më e mirë e mjeteve dhe metodave, renditja më racionale e punës dhe çlodhjes gjatë një procesi stërvitor, disa procese stërvitore, etapave dhe periudhave, dhe e gjithë kjo pandërprerë duke u kujdesur për gjendjen e sportistit. Gjatë aktiviteteve garuese përgatitja kondicionale, teknike e taktike si dhe fushat tjera të përgatitjes së basketbollistëve paraqesin tërsin e ndërlikuar dhe integrale dhe asnjëherë nuk shprehen ndarasi. Çdo ose të gjitha drejtimet e përmendura të përgatitjes sportive në një masë varen nga niveli dhe struktura e drejtimeve tjera të përgatitjes së sportistëve, dhe në këtë mënyrë së bashku ndikojnë në arritjen e rezultateve maksimale-kulmore. Kështu për shembull: përgatitja teknike e sportistëve në sportin e basketbollit në masë të madhe varet nga shkalla e aftësive funksionale dhe lëvizore. Me fjalë të tjera është e pamundur që basketbollistin në mënyrë kualitative ta përgatisim në pikëpamje teknike nëse ai nuk posedon aftësi lëvizore të cilat janë të domosdoshme për realizimin e elementeve teknike të theksuara gjatë lojës, siç janë për shembull: forca, shpejtësia, kordinacioni, fleksibiliteti qëndrueshmëria etj. Efikasiteti i zgjedhjes së teknikave të mësuara është e kushtëzuar me aftësitë e caktuara kondicionale dhe në anën tjetër me aftësitë e basketbollistit për pranimin, përpunimin dhe shfrytëzimit të informacioneve taktike, vendosshmërin e tij dhe shpejtësisë së gjetjes së zgjidhjeve në problemet taktike të cilat lajmërohen në gara. Harmonizimi i të gjitha elementeve kondicionale, teknike e taktike dhe përgatitjes psikologjike paraqesin, pjesën më të rëndësishme të adaptimit sportiv për pjesëmarrje të suksesshme në gara. Lidhshmëria e përgatitjeve të llojeve të ndryshme është e kushtëzuar me qëndrimin specifik të modelimit të procedurave metodike dhe programimit të përgatitjes

kondicionale,taktike e teknike në ciklin shumëvjeçar dhe njëvjeçar të stërvitjes në basketboll.Që nga zanafilla e lojës së basketbollit,trajnerët dhe ekspertët kanë qenë në kërkim të vazhdueshëm të formave dhe metodave të reja të zhvillimit dhe avancimit sa më të hovshëm të sportit të basketbollit në botë.Karakteristikat e mostrës së trajtuar në këtë projekt hulumtues,që sipas moshës kronologjike janë adoleshent,me një tretman të veçantë sistematik si vijues të rregullt të shkollës së basketbollit,dhe si nxënës aktiv në orët e edukatës fizike,mendojmë që do të fitohen të dhëna të vlefshme në këtë hulumtim.

1.1 Vështrim i hulumtimeve të deritanishme

Rezultatet e disa studimeve të kryera me lojtarë të rinjë të lojës së basketbollit janë paraqitur në tekstin në vijim. Blaskovic (1977), të realizuara me ndihmën e baterisë me 110 instrumente matëse për të saktësuar statusin lëvizor (nga kjo, katër teste janë me cak të precizuar dhe tri teste me gjuajtje precize) dhe 23 me masë antropometrike, pra nga këto bateri u dëshmuua pakundërshtueshmëria e ndikimit morfologjik të karakteristikave të aftësive si: forcës, shpejtësisë, fleksibilitetit, koordinimit dhe parcialisht drejtëpeshimit, por jo në rezultatet e testeve që ishin përcaktuar për qëllime të precizitetit por varet nga një sërë faktorësh të ndryshëm.

Klojcnik (1977) ka hulumtuar ndikimin e disa degëve të sportit në zhvillimin e statusit psikosomatik të nxënësve të shkollave fillore. Mostra është përbërë nga 1.455 nxënës, e kanë formuar grupin eksperimentale prej 48 grupeve ku janë përfshirë 799 nxënës dhe grupin kontrollues prej 48 grupeve ku janë përfshirë 656 nxënës. Eksperimenti ka zgjatur një vit sipas programit të përcaktuar për çdo lojë sportive, ndërsa grupi kontrollues ka mbajtur orët e rregullta të edukatës fizike. Rezultatet treguan se ka dallime të mëdha në mes të matjes fillestare dhe përfundimtare. Sipas ndikim në statusin psikosomatik mund të klasifikohen në rendin e mëposhtëm: atletikë, gjimnastikë, basketboll, volejball, not, hendboll dhe futboll.

Firileva (1976, sipas Kocic, 2003) ka hulumtuar karakteristikat e aftësive lëvizor të nxënësve të cilët janë të përfshirë në sporte të ndryshme dhe gjimnastikë artistike. Autori në një mostër prej rreth 8.000 nxënësve të shkollës së Leningradit ka hulumtuar ndikimin e ushtrimeve të rregullta të këtyre sporteve në potencialin lëvizor dhe se a ekziston dallim i rëndësishëm në raport me nxënësit të cilët nuk janë të përfshirë në këto sporte. Ka arritur në përfundim se

ekziston një dallim i rëndësishëm në aftësitë lëvizor midis nxënësve të cilët janë të angazhuar dhe ata që nuk janë të përfshirë në sporte dhe gjimnastikë artistike.

Balla (1980) ka hulumtuar dimensionet lëvizor te femrat dhe meshkujt. Në mostrën prej 3102 nxënësve të të dy gjinitë, të moshës 6-10 vjeç, nga shkollat fillore të zonave urbane të Krahinës Autonome të Vojvodinës, në bazë të njëmbëdhjetë testeve lëvizor, me anë të analizës faktoriale ka vërtetuar se dimensionet lëvizor te meshkujt dhe te femrat të të gjitha moshat. Bazuar në rezultatet e analizës faktor të hapësirës lëvizore, autori arriti në përfundimin se ka të bëjë vetëm me një dimension të përgjithshëm – gjeneral, për shkak se nuk janë të izoluara dimensionet specifike lëvizore. Kjo tregon se në nivel të sistemit nervor qendror nuk kemi diferencim të qartë të qendrave lëvizore..

Dežman (1982) në një mostër prej 560 të testuarve, të rinj të shkollës së basketbollit në Republikën e Sllovenisë (11, 12, 13 dhe 14 vjeçare) ka mbledh të dhëna mbi karakteristikat e tyre antropometrike, si dhe informacion mbi aftësitë themelore dhe të veçanta lëvizore. Karakteristikat antropometrike i ka përcaktuar në bazë të katër masave matëse, ashtu të zgjedhura në mënyrë që kanë prezentuar katër dimensione latente morfologjike. Aftësitë themelore lëvizore ka vlerësuar duke përdorur shtatë teste për vlerësimin e forcës eksplozive, agjilitetit, shpejtësisë së përsëritjes së lëvizjeve, dhe fleksibilitet. Për të përcaktuar aftësitë lëvizore specifike autori ka përdorur gjashtë teste. Përfundim i përgjithshëm i këtij studimi, indi nënlëkuror dhe dhjamor ndikon negativisht në performancën e kryerjes së testeve më të mëdha lëvizore.

Blaskovic me bp.(1993). Ka hulumtuar dallimet në ndikimin e aktivitetit fizik të programuara në orët e edukimit fizik në fushën lëvizore te meshkujt dhe ndikimin e stërvitjeve shtesë të

programuara të lojës së basketbollit në një tjetër grup të meshkujve të njëjtës moshë. Analiza tregoi ndryshime të rëndësishme pozitive në të dy grupet, derisa grupi i trajnuar i variancës ka treguar ndryshime të rëndësishme pozitive tek dy grupet, ndërsa grupi i meshkujve me program shtesë në basketboll ka pasur rezultate më të mira në të gjitha testet për vlerësimin e koordinimit dhe frekuencionin e lëvizjeve.

Marusiç (1994) ka vërtetuar se si lëndët zgjedhore (me theks në gjimnastikë) mund të ndikojnë, ndër të tjera në zhvillimin e disa dimensioneve lëvizore të nxënësve të shkollave fillore të moshës 11 dhe 12 vjeçare. Mostra është nxjerrë nga popullsia e numrit prej 34 nxënësve të klasës së pestë të shkollës fillore në Nikshiq dhe aftësi biomotorike janë vlerësuar nga një bateri prej 21 testeve. Studimi tregoi se ka pasur një përmirësim në 14 ndryshore lëvizore të meshkujve dhe në 12 ndryshore lëvizore të femrave. Rezultatet treguan gjithashtu se tashmë në moshën dymbëdhjetëvjeçare fillojnë të qartësohen dallimet të rëndësishme në drejtim të zhvillimit të aftësive biomotorike të meshkujve dhe të femrave, çka autori thekson në përfundim se mësimi i edukimit fizikë nga klasa e pestë është e nevojshme të organizohet veç për meshkujve e veç për femra.

Šabotić dhe Drobnjak (2007), kanë vërtetuar lidhmëninë e ndryshoreve prediktore të aftësive baziko-lëvizore me ndryshore kriterike të rinjësive të moshës 15 vjeçare.

Repija (2012) në hulumtimin e tij ku qëllimi i hulumtimit ishte ndikimi i orëve shtesë të edukimit fizik në zhvillimin lëvizor të nxënësve të klasëve të ulëta. Numri i përgjithshëm i fëmijëve të cilët e kishin përbërë grupin kontrollues dhe grupin eksperimental dhe që i ishin nënshtruar testimit lëvizor ishte 126 nxënës. Subjektet ishin nxënës të dy shkollave të ndryshme fillore, ku nxënësit në një shkollë (N = 62) përfaqëson grupin eksperimental dhe (N = 64) të tjerët grupin

kontrollues. Instrument matëse për testimin e aftësive lëvizore përbënin 10 ndryshore, tre morfologjike dhe 7 lëvizore. Studimi ishte i karakterit longitudinal dhe kishte zgjatur 12 javë me aq numër të orëve shtesë të trajnimit. Si kriter për rëndësin statistikore është përdorur niveli i probabilitet 95%, respektivisht, $P < 0,05$. Është konkluduar se nuk ishte fituar dallim i rëndësishëm statistikor i proceseve të transformimit të modeleve eksperimentale, por analiza përshkruese ka konfirmuar një përparim të madhë në zhvillimin e aftësive lëvizore te grupi eksperimental.

Petroviq (2009) në hulumtimin e tij ,ku qëllimi i studimit ishte që të hulumtohen efektet e programit të organizuar, posaqërisht të edukimit fizik në disa karakteristika morfologjike, lëvizore dhe psikologjike te nxënësit e klasës së shtatë. Studimi ishte i karakterit longitudinal, me përdorimin e metodave eksperimentale. Mësimi i edukimit fizik i organizuar posaqërisht si faktorë eksperimentale, i planifikuar dhe i zbatuar për një periudhë prej 24 orëve të mësimin, në periudhën nga 15 shtatori deri më 15 dhjetor të vitit 2009. Mostra kishte përfshirë 58 nxënës të klasës së shtatë, të ndarë në katër subklasë të veçanta - sipas kriterëve të gjinisë dhe grupit. Të gjitha ndryshoret që janë përdorur në studim i përkasin hapësirës antropologjike: dy ndryshoreve antropometrike, tre ndryshoreve nga hapësira lëvizore dhe ndryshoret nga përvoja emocionale. Konkluzioni i përgjithshëm i rezultateve të fituara dhe ndryshimi i ndryshoreve të studiuar të subjekteve të meshkujt dhe të femrat, mund të shprehet me këto përfundime: mësimi i edukimit fizik, me një program të veçantë të objekteve të organizuara, nuk ka pasur efekt të rëndësishëm statistikor të karakteristikat antropometrike të meshkujt dhe të femrat. Ndikimi pozitiv ishte në përmirësimin e aftësive lëvizore, dhe ngritjen e gjendjes emocionale në orët e

edukimit fizik, si dhe në rritjen e kohës së ushtrimeve. Mësimi i tillë mund të jetë një bazë e besueshme dhe rekomandimi i edukimit dhe arsimimit fizik bashkëkohor.

Ljubojević Višnjić dhe Ilić _ (2012) në hulumtimin e bërë në mostrën prej 140 nxënësve, të ndarë në grupin kontrollues (31 meshkuj dhe 30 femra) dhe grupin eksperimental (42 meshkuj dhe 37 femra), nxënës të klasëve të shtata. Grupin kontrollues e përbënin nxënësit që kanë vijuar rregullisht orët e edukimit fizik, dhe grupin eksperimentale e përbënin nxënësit, të cilët përveç orëve të edukimit fizik, kishin edhe dy orë të basketbollit, të cilat ata vetë i kanë zgjedhur. Ndryshimet të testuarit janë përcjellur me anë të shtatë ndryshoreve lëvizore. Studimi ka zgjatur njëgjysmëvjeter. Rezultatet treguan se nën ndikimin e programit të basketbollit ka pasur një ndryshim të meshkujt ndërsa të vajzat, nuk kishte asnjë ndryshim në ndryshoret e matura.

H.Saliu: Në temën e magjistraturës “Relacionet e disa karakteristikave morfologjike dhe aftësive lëvizore të përgjithshme dhe situacionale tek basketbollistët e rinjë“. Modeli (mostra) prej 108 basketbollistëve të rinjë ka vërtetuar strukturë dhe relacione të rëndësishme ndërmjet sistemit të ndryshoreve morfologjike dhe aftësive lëvizore bazike e situacionale ka përfshirë 21 ndryshore prej të cilave ka përfituar 5 faktor me rëndësi si vijon; dy faktorë nga hapësira morfologjike ndërsa tre faktorë nga hapësira lëvizore bazike e situacionale, e rëndësisë së veçantë në këtë punim vlen të ceket sepse autori ka bërë krahasimin e rezultateve në testin, gjatësia e trupit të mostrës identike me një punim nga Bosnja Hercegovina, dhe si rezultat tregon se të rinjë nga Kosova konkretisht nga kryeqyteti Prishtina janë me rezultat më të mirë për 4cm. Punim Magjistrature 2000. Prishtinë.

Relacionet e disa Karakteristikave Morfologjike dhe aftësive lëvizore të të rinjë

Punim Magjistrature (H. Salihu. 2000). Autori ka hulumtuar moshën 14-15 vjeç, ka fituar 2 faktorë morfologjik dhe tre nga aftësitë lëvizore bazike dhe specifike – tipike për lojën e basketbollit.

Eksperimentimet-hulumtimet kineziologjike mund të trajtohen si detyrë interesante kërkimore e disa karakteristikave morfologjike dhe lëvizore të përgjithshme dhe situacionale, si në hapësirën manifeste ashtu edhe në atë latente duke u bazuar në arritjen e rezultateve të diciplinave sportive, gjithashtu janë përcaktuar në ato hulumtime të profileve të ndryshme nga autorët tanë autokton dhe të jashtëm e sidomos që kanë të bëjnë kryesisht me laminë e basketbollit.

H.Bytyqi: Analiza komparative e disa ndryshoreve morfologjike dhe aftësive lëvizore bazike e situacionale tek basketbollistët e rinj. Në këtë hulumtim të realizuar me të rinj kadetë të mëdhenj, të moshës 15 -16 vjeçe të cilët vijojnë trajnime nëpër klube (shkolla të basketbollit) nga dy vendet e ndryshme, vërehet se disa nga ndryshoret antropometriket të përfshira në punim kanë dhenë dallime të rëndësishme statistikore. Në bazë të rezultateve të fituara mund të konstatojmë se në parametrat themelor bazik janë vërejtur ndryshimet në mes të dy grupeve për shkak të të ushtruarit, ku rezultatet që janë paraqitur kanë shpërndarje heterogjene.

Në mënyrë të detajuar janë paraqitur edhe rezultatet të vlefshme në lëvizjet situacionale tipike për lojën e basketbollit ku vërehet një ngritje e aftësive lëvizore gjë që është për tu përshëndetur mirëpo jo në nivel të kënaqshëm që na lë të kuptojmë se në të ardhmen ne duhet ti kushtojmë rëndësi më të theksuar, programeve të planifikuara mirë, moshës adekuate, tretmani lëvizor dhe pubertetit etj.

2. QËLLIMI I PUNIMIT

Morfologjia lëvizore bazike e situacionale të basketbollistëve duhet të jenë preokupime të trajnerëve dhe stafit drejtues të ekipeve, nga të cilet varet edhe niveli shëndetësor, social dhe sportiv i një shoqërie.

Problemi i këtij hulumtimi paraqet analizimin e disa parametrave morfologjik, lëvizor bazik e situacionale të basketbollistëve dhe i nxënësve të të njetës moshë. Problemi i cili trajtohet në këtë punim është i një rëndësie të veçantë, sepse nga rezultatet e fituara mund të vlerësojmë dhe të jepet një pasqyrë reale e zhvillimit lëvizor të kësaj popullate si dhe të japim një pasqyrë sa më reale të ndikimit të faktorëve të ndryshëm morfologjik, lëvizor e situacionale në realizimin e detyrave tekniko-taktike gjatë lojës.

Qëllimi primar i këtij punimi është vërtetimi i dallimit në mes basketbollistëve dhe nxënësve të moshës 14 vjeçare në disa karakteristika antropometrike, aftësi lëvizor bazike e situacionale.

Qëllimi sekondar i këtij punimi është të përcaktohet niveli i ndikimit të tretmanit stervitor të basketbollistët e rinj në parametrat morfologjik, lëvizore bazike e situacionale.

Detyrat – Për realizimin e qëllimit, janë parashtruar këto detyra të hulumtimit:

- Vërtetimi i karakteristikave morfologjike në të dy grupet.
- Vërtetimi i karakteristikave kuantitative mbi nivelin e aftësive bazike lëvizore të sportistëve dhe jo sportistëve.
- Vërtetimin e ndryshimeve në aftësit lëvizore, ndërmjet dy grupeve aktiv dhe jo aktiv.
- Vërtetimi i relacioneve ndërmjet testeve bazike dhe lëvizore tipike për lojën e basketbollit.

2.1 Hipotezat themelore

Më qëllim të vërtetimit të saktë dhe shkencorë të ndryshoreve të hulumtuara dhe objektivave primare janë paraparë këto hipoteza themelore:

H1 - Kemi dallime të vlefshme në ndryshoret antropometrike dhe atyre lëvizore në G1 dhe G2.

H2 -Vërtetohet shpërndarja heterogjene e rezultateve në ndryshoret specifike të lojës së basketbollit.

3. METODOLOGJIA E PUNËS

3.1. MOSTRA E ENTITETEVE

Në këtë projekt janë trajtuar basketbollistët e rinjë të moshës 14 vjeçarë ku numri i përgjithshëm do të jetë i definuar nga 30 basketbollistë të cilët i takojnë shkollës së basketbollit KB.Ylli nga Suhareka, dhe 30 nxënësit e shkollës fillore “7 Marsi” nga po i njeti vend.

- Grupi i parë G1 përfshin gjysmën e këtij hulumtimi i cili është i definuar prej të rinjëve të shkollës së basketbollit KB.YLLI pjesmarrës në gara kampionale gjatë sezonit 2014-2015.
- Grupi i dytë G2 e përbëjnë numri i njejtë i të rinjëve të cilët janë nxënës të regulltë të shkollës fillore “7 Marsi” të cilët aktivitetin fizik e bëjnë vetëm në orët e edukatës fizike,dy herë në javë nga 45 min.

Mostra e cila do të trajtohet në këtë punim te të dy grupeve janë të rinjët e qytetit të Suharekës.

3.2. MOSTRA E NDRYSHOREVE

Mostra e të rinjëve në këtë projekt të të gjitha moshave dhe grupeve,do ti nënshtrohen procedurave të testimit në kushte të njejta, para fillimit të orës stërvitore. Grupin e parë të ndryshoreve e përbëjnë testet antropometrike, testet e aftësive levizore të karakterit bazik, ndërëkaq grupin e dytë e përbëjn ndryshoret situacionale tipike të lojës së basketbollit.

MOSTRA E NDRYSHOREVE

3.2.1. Ndryshoret antropometrike

Janë aplikuar këto ndryshore morfologjike:

- **APESHA** – Pesha e trupit
- **ALARTË** – Lartësia e trupit
- **AGJKRA** – Gjatësia e krahut
- **AGJKËM** – Gjatësia e këmbës
- **AGJSHDO**- Gjatësia e pëllëmbës së dorës
- **AGJESHDO** – Gjerësia e pëllëmbës së dorës
- **AGJERSHK** – Gjatësia e shputës së këmbës
- **AGJERSHKE**- Gjerësia e shputës së këmbës

3.2.2. Ndryshoret lëvizore bazike

Për vlerësimin e aftësive lëvizore bazike janë përfshirë këta ndryshor:

- **MKVGJVE** – Kërcim së largu nga vendi
- **MKVLART** – Kërcim së larti nga vendi
- **MV20MS** – Vrapim në 20 metra nga starti lartë
- **MV2X20MT** – Vrapim 2x20 metra nga starti lartë me top
- **MHTBAS** – Hudhja e topit të basketbollit

3.2.3. Ndryshoret lëvizore situacionale (specifike).

Për vlerësimin e aftësive lëvizore specifike janë përfshirë këta ndryshor:

- **MGJGJDI** – Gjuajtje me kërcim nga 5 pozicionet 4.20m.
- **MGJLDD**. – Gjuajtjet e lira me dorën e djathtë
- **MGJLDM** - Gjuajtjet e lira me dorën e majtë.

3.4. KUSHTET E MATJES

1. Matjet antropometrike janë ekzekutuar në orët e para të paradites.
2. Instrumentet matëse të punimit kanë qenë standarde dhe valide.
3. Vendi ku janë ekzekutuar matjet ka qenë hapsirë e mjaftueshme dhe e ndriçuar mirë,ndërsa temperature e ajrit ka qenë rreth 22⁰.
4. Në vendin ku janë ekzekutuar matjet (sallë e edukatës fizike) kanë qenë pesë matës,shkruesi i rezultateve dhe grupi prej pesë të testuarve të cilët janë zëvendësuar pas matjes.
5. Të testuarit para matjes kanë qenë zbathur dhe vetëm në brekë.
6. Te çdo i testuar,para matjes,janë përcaktuar dhe shënuar në mënyrë të saktë nivelet dhe pikat antropometrike të cilat kanë qenë në programin e matjeve.
7. Dimensionet e caktuara antropometrike çdo herë i ka matur i njëjti testues.Rezultatet e matjes janë lexuar gjatë kohës deri sa testuesi është matur,ndërsa personi i cili ka shkruar rezultatet,për ti kontrolluar i ka përsëritur rezultatet me zë të qart.
8. Matjet e segmenteve çift të trupit janë ekzekutuar në anën e majtë të trupit.
9. Matjet antropometrike janë përsëritur nga tri herë

3.5. MJETET MATËSE ANTROPOMETRIKE

Për aplikimin e këtij programi të matjeve janë shfrytëzuar këto mjete antropometrike:

1. Peshorja (transportabile) e cila mundëson matjen me saktësi prej 0,5 kg. Peshorja kontrollohet çdo ditë para përdorimit dhe pas çdo dhjetë matjeve.



2. Antropometer Martinit (në të cilën janë të shënuar centimetrat dhe milimetrat).



3. Traka matëse prej materiali të plastikës me gjatësi prej 1.50 cm (në të cilën janë të shënuara centimetrat dhe milimetrat).





4. Antropometri sipas Martinit (bëhet matja e gjatësisë trupore në të cilën janë të shënuara centimetrat dhe milimetrat).

3.5.1 Masa trupore (MT)

Masa trupore është matur me peshoren digjitale, e cila mundëson saktësinë në 0.1 kg. Peshorja është vendosur në pozitë horizontale në bazë të fortë. Subjektet matjen e kanë kryer të zbathur dhe me veshje të lehta sportive, duke qëndruar i qetë mbi peshore.

Foto 1. Matja e peshës trupore (APESHA).



3.5.2 Lartësia trupore (LTR)

Matja e lartësisë është bërë me antropometër. Subjektet matjen e kanë kryer të mbathur dhe me veshje të lehta sportive, duke qëndruar mbi sipërfaqe të fortë. Individët kokën e kanë mbajtur duke iu përmbajtur horizontales së Frankfurtit (skaji i poshtëm i syrit dhe skaji i epërm i kanalit të jashtëm të veshit të jenë në pozitë horizontale). Qëndrimi i trupit ka qenë i relaksuar dhe i drejtë, ndërsa shputat të bashkuara. Matësi ka qëndruar në anën e djathtë të individit.

Foto 2. Matja e lartësisë trupore (ALART).



3.5.3. Gjatësia e këmbës (GJAK).

Është matur me antropometër,i eksperimentuari ka qëndruar sikurse në matjen e lartësisë së trupit, matja është bërë nga dyshemeja ku ka qëndruar entiteti deri në pikën e quajtur “gjembi i sipërm i përparme i capokut “ (spina iliac anterior superior) të anës së majtë,e cila i caktohet me gishtin e mesëm të dorës që mban pjesën horizontale të antropometrit, rezultati është lexuar me saktësi 0.01 cm.

Foto 3 Matja e gjatësisë së këmbës (AGJKAM).



3.5.4. Gjatësia e krahut (GJK).

Është matur me antropometrin e shkurtuar,entiteti apo i testuari ka qëndruar në këmbë në pozitë të drejtë.Ngjajshëm me pozitën e matjes së lartësisë trupore,me dorën dhe shuplakën e majtë të shtrirë lehtësisht e të larguar nga trupi,njëri skaj i antropometrit vendoset në maje të gishtit të mesëm të dorës së majtë,kurse tjetri skaj aty ku është lexuar rezultati në zgjatim shpatullor(processus akromialis) të anës së njëjtë.Rezultati është lexuar me saktësi 0.1 cm.

Foto 4 Matja e gjatësisë së krahut (AGJKRAH).



3.5.5 Gjatësia e shputës së këmbës (GJSHKAM).

Është matur me antropometër të shkurtuar i testuari ka qëndruar ulur, te këmba e majtë e mbledhur që formon këndin e drejtë dhe me shputë të vendosur në dysheme. Matësi i vendos krahët e antropometrit në thembër dhe në gishtin më të gjatë (thonjtë duhen të jenë të prerë), rezultati është lexuar me saktësi prej 0.1 cm.


Foto 5 Matja e gjatësisë së shputës së këmbës (AGJSHKA).



3.5.6 Gjerësia e shputës së këmbës (GJESHPK).

Është matur me antropometër, i testuari ka qëndruar në pozitë të drejtë me baraspeshim në të dy këmbët, me shputa të vendosura paralel dhe për një gjërësi të shputës të ndarë njëra nga tjetra. Matja është bërë nga lartë (ana dorëzale) krahët e kompasit janë vendosur në pjesën metatazale të shputës, aty ku është gjërësia më e madhe. Saktësia e matjes ka qenë 0.1 cm.

Foto 6. Matja e gjerësisë së shputës së këmbës (AGJESHKM).



3.5.7 Gjatësia e pëllëmbës së dorës (GJPD)

Gjatësia e pëllëmbës së dorës matet me kompas rrëshqitës me krah më të gjatë, i testuari qëndron me krahun e majtë të shtrirë mbi gjurin e majtë. Dora e majtë duhet në bërryl të jetë në fleksion 90° (shkallë) me pëllëmbë të kthyer në drejtim të dyshemesë, dhe me gishtrinjë të mbledhur dhe të shtrirë horizontalisht. Njëri krah i instrumentit vendoset në daktilin, ndërsa tjetri krah në interstilion (pika ndërmjet zgjatimit stiloid radial dhe ulnar), rezultati lexohet me saktësi 0.1 cm.

FOTO 7. Matja e gjatësisë së pëllëmbës së dorës (AGJATSHPD).



3.5.8 Gjerësia e pëllëmbës së dorës (GJRPD).

Gjerësia e pëllëmbës së dorës matet me kompas, i testuari qëndron me dorën e majtë në pozitë të njëjtë me pozitën gjatë matjes së diametrit të nyjëtimit të dorës, (me dorën e majtë të fletuar në bërryl në kënd të drejtë, me pëllëmbë të kthyer ka dysHEMEJA dhe me gishtrinjë të drejtuar e të ofruar). Krahët e instrumentit matës vendosen lateralishtë në ashtin e dytë dhe të pestë metakarpal (pika metakarpale radiale dhe ulnare), rezultati lexohet me saktësi 0.1 cm.

FOTO 8. Matja e gjerësisë së pëllëmbës së dorës (AGJERSHPD).



3.6. MËNYRA E TESTIMIT – PËRSHKRIMI I TEKNIKËS SË MATJEVE

3.6.1. Kërcim nga vendi në gjatësi KVGJ

Me këtë rast është vlerësuar forca eksplozive e gjymtyrëve të poshtme.

Përshkrimi i detyrës :Pozita fillestare,i testuari vendoset me të dy shputat në dysHEME, me fytyrë nga drejtimi i kërcimit. Realizimi i detyrës:I testuari në përkulje të vogël në gjunjë duke e shfrytëzuar edhe hovin e krahëve realizon kërcim me të dy këmbët para.Detyra përsëritet tri herë ndërkaq shënohet rezultati më i mirë.

Vlerësimi: Shënohet rezultati i kërcimit më të gjatë nga vendi i shtytjes deri të gjurmët e pjesës së pasme të shputave në saktësi 1 cm.

Udhëzimet: Kërcimi përsëritet nëse i testuari kërcen në vend para kërcimit para,nëse kërcimi realizohet me një këmbë, pas rënies mbështetet prapa në duar etj.

Foto 9. Matja e kërcimit nga vendi në gjatësi (MKVGJ).



3.6.2 Kërcim nga vendi në lartësi (MKVL)

Mënyra e realizimit të testit.

Vendi: Është mobilizuar antropometri për muri.

Pozita fillestare: I testuari qëndron afër antropometrit brinjazi, me krahun e djathtë të ngritur lartë dhe duke i mbështetur gishtërinjët e dorës në mur. Në këtë moment shënohet lartësia e prekjes së gishtave në mur.

Realizimi i detyrës: Subjektet janë shkëputur me të dy këmbët nga toka në lartësi duke prekur murin me dorën e djathtë në lartësinë maksimale, testi përsëritet tri herë. Rezultati shënohet me saktësi prej 1 cm.

Foto 10. Matja e kërcimit në lartësi (MKVL).



3.6.3 Vrapim 20m. nga starti i lartë.

Me këtë test është vlerësuar aftësia e shpejtësisë së vrapimit.

Përshkrimi i detyrës:

Pozita fillestare: I testuari përgatitet për vrapim pran vijës së startit, në pozitë të startit të mesëm.
Realizimi i detyrës: Pas komandës “gati” nga matësi dhe sinjali “nisu” i testuari me shpejtësi maksimale vrapon gjatësinë e shtegut 20m. Vlerësimi: Matet koha nga dhënia e sinjalit deri në momentin kur i testuari kalon me trungun vijën e paramenduar (caktuar). Koha matet në saktësi 0.01 sec. Udhëzimet e testit: Në rast të startit jo të rregullt vrapimi përsëritet, i testuari udhëzohet që pas arritjes në vijën e caktuar të vazhdojë vrapimin dhe për disa metra duke u ndalur në mënyrë graduale.

Fotot 11. Vrapim 20 metra nga starti i lartë (MV20MS)



3.6.4 Vrapim 2x20m. nga starti i lartë me top.

Me këtë test masim aftësitë anaerobe në gjatësi 2x20 metra “vajtje-ardhje”, në raport me kohën.


Mjetet: topi i basketbollit, pipi për sinjalizim dhe kohëmatësi.

Përshkrimi i detyrës:

Detyra e subjektit është që ta kalojë shtegun duke dribluar topin “vajtje-ardhje”, me shpejtësi maksimale, por pa i thyer rregullat e driblimit dhe hapave. Startohet nga vija fundore deri te koni i vendosur në 20m. dhe anasjelltas. Rezultati vlerësohet me saktësi 0.01 sekonda.

Vlerësimi. Udhëzimet e testit: Në rast të startit jo të rregullt, vrapimi përsëritet i testuari udhëzohet që pas arritjes në vijën e caktuar të vazhdojë vrapimin dhe për disa metra duke u ndalur në mënyrë graduale.

Foto 12. Vrapim 2x20m. nga starti i lartë me top(MV2x20MT)



3.6.5 Hedhja e topit të basketbollit në largësi.

Me këtë testë është vlerësuar forca eksplozive e gjymtyrëve të sipërme.

Përshkrimi i detyrës:

Pozita fillestare: I testuari vendoset në qëndrim basketbollistik (paralel) ,me fytyrë nga drejtimi i hedhjes.

Realizimi i detyrës:I testuari mban topin në duar para gjoksit, realizon hedhjen e topit para vetëm me lëvizjen e krahëve,i testuari detyrën e përsërit dy herë ndërkaq shënohet rezultati më i mirë.Vlerësimi: Shënohet vendi më i gjatë i hedhjes në saktësi 5cm.Udhëzime e subjektit: Hedhja përsëritet në rast se i testuari nuk i përmbahet udhëzimeve të dhëna,ose në rastin e hedhjes së topin me njërin dorë,ose me vrull mbrapa kokës.

Fotot 13. Hedhja e topit të basketbollit në largësi.



3.7 Ndryshoret lëvizore situacionale.

3.7.1 Gjuajtjet në kosh me kërcim nga pesë pozicione (GJ5POZ).

Testi i precizitetit gjuajtje nga 5 pozita, me këtë test është vlerësuar preciziteti nga gjuajtjet brenda perimetrit 6.75 një metër më afër kësaj distance 5.75.

Përshkrimi i detyrës: Pozita fillestare, gjuajtjet realizohen nga vendi me kërcim ku janë të vendosur pengesat dhe topat përmbi, kapja e topit me një taktë dhe gjuajtje bëhet me kërcim, distanca mes pengesave ka qenë 4.20 m. nga njëra tjetra, gjuajtja fillon nga ana e djathtë e fushës së basketbollit, duke vazhduar deri në përfundim, ku procedura është e njëjtë.

Foto 14. Gjuajtjet në kosh me kërcim nga distanca 5.75m. nga 5 pozicione (GJ5POZ).



3.7.2 Gjuajtjet e lira me dorën e djathtë (GJLDD).

Me këtë test masim precizitetin e gjuajtjeve për një pikë me dorën e djathtë.

Mjetet: Topi i basketbollit, një ndihmës, hapësira e gjuajtjeve të lira.

